



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 577 Prot.

Maliq, më 23.10.2020

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, “Funksionimi i këshillit bashkiak”, pika 2, pika 4, neni 56 “Kryetari i këshillit bashkiak” gërma a, dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq” ju njoftojmë se mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Maliq do të mbahet ditën e **premtë , datë 30.10.2020, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2020”;
3. P-V “Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë dhe akordim fondi për shoqatën joqeveritare ‘Dorkas’ në mbështetje të fushatës ‘Kovat Blu’”;
4. P-V “Për dhënie ndihme financiare” për familjen e z. Fatos Çallëku, z. Kudret Pashollari dhe z. Bledar Kulla banesa e të cilëve u dogj si shkak i rënies së zjarrit”;
5. P-V “Për një shtesë në vendimin nr. 153, datë 20.12.2019 të Këshillit të Bashkisë Maliq, “Për miratimin e punonjësve, nivelin e pagave të administratës (qendër), njërive administrative dhe drejtorive në Bashkinë Maliq për vitin 2020”;
6. P-V “Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.135, datë 30.10.2019, për procedurën e privatizimit të sipërfaqes prej 57.57 m², pjesë e pasurisë nr. 701/9-N1, ZK 3010, fshati Podgorie, NJA Vreshtas, Bashkia Maliq”;
7. P-V “Rishkimi i vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 44, datë 26.06.2020, mbi propozimin për shprehjen e dakortsisë nga Këshilli i Bashkisë Maliq për vijimin e procedureve të heqjes nga fondi pyjor i sipërfaqes që preket nga veprimtaria e shfrytëzimit mineral me lejë nr. 653/1 (aktualisht), nr.653/2) datë 19.11.2020 nga shoqëria Favina shpk”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK**

8. P-V "Rishkimi i vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 45, datë 26.06.2020, mbi propozimin për shprehjen e dakortsisë nga Këshilli i Bashkisë Maliq për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor i sipërfaqes që preket nga ndërtimi i Hec Empire nga shoqëria Eralda Intimo shpk".
9. P-V "Për dhënien me qira të një sipërfaqe në administrim të ish-Kombinatit të Sheqerit sh.a Maliq";
10. P-V "Për ngritjen e "Këshillit Rinor Vendor" pranë Bashkisë Maliq"
11. Shqyrtimi i kërkesave, ankesave dhe shkresave drejtuar Këshillit Bashkiak.
12. Diskutime të tjera.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

